



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 12157 prot.

Elbasan, më 23. 11.2023

Lënda: Kthim Akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.105 dt.31.10.2023 “Propozim për dhënie me qira të pasurisë shtetërore”, ju sqarojmë si më poshtë:

Objekti i aktit tuaj është dhënia me qira me afat 1 (një) vit e një sipërfaqeje prej 40m², e pasurisë nr.9/207, ZK 2446, e llojit truall në pronësi shtet.

Bazuar në VKM nr. 54 datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, së cilës i jeni referuar dhe ju në marrjen e vendimit, në Kreun I, në fund të pikës 6 a) përcaktohet se :

Institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m².

Institucioni shtetëror, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore, mund të japë me qira, për një afat deri në 1 (një) vit **objekte** që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale), por jo, vetëm truall të lirë.

Duke qenë se sipërfaqja që kërkoni të jepni është vetëm truall i lirë me sipërfaqe 40m², kjo gjë bie në kundërshtim me dispozitat e VKM-së së sipërcituar.

Sa më sipër aktin tuaj e kthejmë si të pabazuar në ligj.

PREFEKTI



Majlinda Perriu